

## NAIM FRASHËRI

### Fyelli

Pa dëgjo fyellin ç'thotë  
Tregon mërgimet' e shkretë,  
Qahet nga e zeza botë,  
Me fjalëzë të vërtetë:

Që kur se më kanë ndarë  
Nga shok' e nga miqësija,  
Gra e burra kanë qarë  
Nga ngashërimat' e mija!

Krahërorë e kam çpuar,  
E kam bërë vrima-vrima,  
Dhe kam qar' e kam rënkuar  
Me mijëra psherëtima!

Dhe me botën e gëzuar  
Bënem shok edhe marr pjesë,  
Dhe me njerës të helmuar  
Bënem mik me besa-besë.

Puna si do që të bjerë,  
Unë qanj me mallëngjime,  
Më çdo vënt e kur-do herë  
Psherëtin zëmëra ime!

Gjithë bota më dëgjojnë,  
Po së jashtësmi më shohin,  
Dëshirën s'm'a kuptojnë,  
Zjarr' e brëndëshmë s'm'a njohin!

Njerëzit me mua rrinë,  
Unë qanj e mallëngjehem,  
Po dufn' e pshehtë s'm'a dinë,  
Andaj kurrë s'përdëllehem.

Gjith' ata që janë ndarë,  
Fyellit shokë i-u bënë,  
Shkallët' e tij disa farë,  
Na shkalluan mëndjen t'ënë.

O rrëmet' i njerëzisë!  
Zër' i fyellit s'është' erë,  
Ky 'shtë zjarr' i dashurisë,  
Që i ra kallamit mjerë!

I ra qiellit, e ndriti,  
I ra zëmërsë, e nxehu,  
I ra verës, e buçiti,  
I ra shpirtit, dhe e dehu.

I dha erë trëndafilin,  
I dha dritë bukurisë,  
I dha këngëtë bilbilit,  
I dha shije gjithësisë.

Ajy zjar ra dhe në qiej,  
Edhe duke përvëluar,  
U bënë kaq' yj e diej,  
Që i mba Zoti ndër duar,

Nga ky zjar Zot' i vërtetë,  
Që ka ngehur gjithësinë,  
Hoth një shkëndijë në jetë,  
Dhe bëri soje njerinë.

O more Zjar i bekuar!  
Unë me ty jam përzjerë!  
Pa jam tretur e kulluar,  
Po të kam shpirt, mos më lerë.